REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr._____Prot Shkodër, më ___.___.2026

Lënda: Kthim përgjigje.

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës, me nr. Prot. 18753 me dt. 17.07.2026 ku kërkohet informacion i detajuar, ju bëjmë me dije se një pjesë e informacionit të kërkuar administrohet nga institucionet publike si më poshtë:

· **FSHZH -** Autoriteti përgjegjës për projektin Shirokë–Zogaj–Kufi dhe Muzeu i Lundrimit.

· **ARRSH -** Autoriteti përgjegjës për projektin Ura e Bahçallëkut dhe zgjerimi i rrugës

· **UK Shkodër -** Autoriteti përgjegjës për projektin Impianti i Trajtimit të Ujërave të Përdorura.

Më poshtë gjeni informacionin mbi statusin e kërkuar për objektet e **FSHZH-së**:

1. Objekti "**Rikonstruksioni i rrugës Shirokë – Zogaj – Kufi**", i financuar nga BERZH dhe Bashkimi Evropian në kuadër të programit AITP, ka arritur në fazën përfundimtare të zbatimit, me rreth 95% të punimeve të realizuara.
   Aktualisht, po kryhen punimet për vendosjen e sinjalistikës horizontale, vertikale dhe ndricimit. Pas përfundimit të tyre, objekti do t'i dorëzohet Bashkisë Shkodër, si përfituese e këtij investimi.
   Segmenti i rikonstruktuar, me gjatësi rreth 6 km, është i aksesueshëm dhe i hapur për qarkullimin e automjeteve. Punimet për rrjetin e ujërave të zeza edhe punimet për linjën nëntokësore të tensionit të mesëm (TM) kanë përfunduar në të gjithë aksin rrugor, në përputhje me projektin e miratuar.
2. Objekti **"Muzeu i Navigimit"**, i financuar nga BERZH dhe Bashkimi Evropian në kuadër të programit AITP, është në fazën e zbatimit, me afat të rishikuar për përfundimin e punimeve deri në muajin gusht 2026. Pas përfundimit të punimeve, objekti do t'i dorëzohet Bashkisë Shkodër, si institucioni përfitues i këtij investimi. Objekti është konceptuar si një muze lokal dhe, pas marrjes në dorëzim, do të administrohet nga Bashkia Shkodër.

   Kontrata aktuale përfshin realizimin e punimeve civile dhe furnizimin me një pjesë të pajisjeve të nevojshme për funksionimin e muzeut. Megjithatë, ajo nuk përfshin

   procesin e muzealizimit, kurimin e ekspozitave dhe plotësimin e përmbajtjes muzeore, elemente të domosdoshme për ta bërë muzeun plotësisht funksional, të vizitueshëm dhe të aksesueshëm për publikun.

   Aktualisht, FSHZH, Bashkia Shkodër dhe specialistë të fushës, janë duke bashkëpunuar me synim hartimin dhe zbatimin e zgjidhjeve më të përshtatshme për muzealizimin e objektit. Ky investim konsiderohet me rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të rajonit.

Më poshtë gjeni informacionin mbi statusin e kërkuar për objektet e **UK Shkodër**:

1. Cili është statusi aktual i projektit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura të qytetit të Shkodër?

Për projektin është miratuar oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit.

2. A ka përfunduar procedura e prokurimit të punimeve ? Nëse po , cili është operatori fitues dhe kur është nënshkruar kontrata?

Jo , nuk është akoma në këtë fazë.

3. A kanë nisur punmet në terren? Nëse po , në cilën datë?

Jo.

4. Cili është afati kontraktor për përfundimin e projektit?

Afati do të jetë 39 muaj kalendarik nga fillimi i kontratës.

5. Cila është vlera totale e investimit dhe si ndahet financimi mes Bashkimit Europian, Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë Zviceriane?

Ju informojmë se institucioni ynë nuk disponon informacionin e kërkuar, pasi ai nuk ndodhet në administrimin apo kompetencën tone në këtë fazë.

6. Cfarë komponentesh përfshin konkretisht projekti (impianti, stacioni i pompimit, linja e transmetimit, micro-tunelimi etj)

-Përmirësimi i Stacionit të Pompimit Kryesor (*MPS*) të Shkodrës (*instalimi i një grirësi automatik për ujërat e ndotura, ndërrimi i pompave*)

-*Ndërtimi i Rrjetit të Pompimit* të Ujërave të Ndotura / *Tubit të Presionit me Diametër 600* (midis MPS dhe vendit të parashikuar të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, me një gjatësi prej rreth 5.015 km që kalon lumin Buna,

-*Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura* Shkodra për kapacitet trajtimi (ngarkesë hidraulike 55% e rrjedhës përfundimtare të projektuar), procesi i balastimit të ujërave të ndotura me ngarkesë të aktivizuar për stabilizimin e llumit me aeracion të zgjatur

7. A kanë përfunduar të gjitha procedurat për shpronësimet, lejet dhe VNM?

Projekti është pajisur me "Deklaratë mjedisore" të lëshuar me datë 18.08.2025. Aktualisht po bëhen proçedurat për shpronësimet të domosdoshme për të proçedurar me pajisjen për Leje ndërtimi.

8. Cfarë ndikimi konkret pritet të ketë projekti në reduktimin e ndotjes së Liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe lumit Drin?

Qëllimi kryesor i projektit të ujit dhe kanalizimeve MIP V në Shkodër është të përmirësojë ndjeshëm grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në qytet. Ky projekt synon të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit, si dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë e Shkodrës. Projekti do

të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e ujit duke trajtuar ujërat e zeza dhe sigurimi i perputhshmerise me standardet kombëtare të cilësisë së ujit, konkretisht:

Ulja e ngarkesës organike (BOD dhe COD) – Reduktohet sasia e lëndëve organike që shkarkohen në ujërat pritëse, duke përmirësuar cilësinë e ujit.
Reduktimi i lëndëve të pezulluara (TSS) – Hiqen grimcat e ngurta që rrisin turbullirën dhe dëmtojnë habitatet ujore.
Reduktimi i lëndëve ushqyese (azot dhe fosfor) – Kufizohet eutrofikimi, duke parandaluar lulëzimin e algave dhe uljen e oksigjenit të tretur.
Përmirësimi i oksigjenit të tretur në ujërat pritëse – Me më pak lëndë organike për t'u dekompozuar, rritet niveli i oksigjenit, duke krijuar kushte më të mira për organizmat ujorë.
Reduktimi i ndotjes mikrobiologjike – Ulja e baktereve patogjene, viruseve dhe parazitëve zvogëlon rrezikun për shëndetin publik dhe për përdorimet rekreative të ujit.
Mbrojtja e biodiversitetit ujor – Përmirësimi i cilësisë së ujit favorizon ruajtjen dhe rikuperimin e florës dhe faunës ujore.
Përmirësimi i cilësisë estetike të ujërave – Ulen turbullira, ngjyra, aromat e pakëndshme dhe grumbullimi i mbetjeve lundruese.
Reduktimi i akumulimit afatgjatë të ndotësve në sedimente – Më pak ndotës depozitohen në fundin e trupave ujorë, duke përmirësuar gjendjen ekologjike në afat të gjatë.
Rritja e potencialit për përdorime ekonomike të ujërave – Ujërat më të pastra mbështesin peshkimin, turizmin, rekreacionin dhe aktivitete të tjera ekonomike.

Lidhur me informacionin e kërkuar për projektin "**Ura e Bahçallëkut dhe zgjerimi i rrugës**", ky investim ka filluar të reduktojë fluksin e trafikut në qytet. Për informacion të metejshëm mund ti drejtoheni ARRSH.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Benet BECI